

Death-relating words in Albanian. A linguistic and cultural study on euphemisms

Abstract: *Studies on taboos maintain that there is a tendency to avoid notions which convey emotional weight for people. One of the taboo concepts is death. Its communication in private and public activates a series of discourse strategies, which on the linguistic level generate a multitude of lexical and phraseological variants. The commitment to resisting the direct mention of such terrible event propels an alternative discourse fuelled by the anguish of death. In fact, euphemisms constitute a form of re-creative communication: they are not simply about lexical substitutions but also about linguistic devices that produce cultural units. They reflect the way a society, a certain community, reacts to death. Unlike what happens with certain topics which until lately were taboos, but not anymore now, there persists a lot of reluctance to include death among the human conditions. Narratives about death are conditioned not only by the linguistic system but also by beliefs, rituals and the imagination of speakers. This article explores the linguistic aspect along with the inevitable connotations of the cultural nature of euphemistic expressions acting as mitigating, evasive or regulating mechanisms of such a phenomenon. As in many other languages, in Albanian there is a wide use of euphemisms related to the semantic field of death. In this paper, the authors aim to analyse the structural-formal and semantic aspect of these units.*

Keywords: *Euphemism, Death, Language devices, Cultural context, Albanian language.*

1. Hyrje

Kultura e sotme synon përsosjen e performancës, si në rrafshin fizik, ashtu edhe në atë intelektual, duke i vënë këto në funksion të suksesit dhe të afirmimit personal. Kjo mënyrë jetese, e mbështetur në emocione dhe në kërkesën për arritje të vazhdueshme, e shtyn në skaje mendimin për vdekjen. Rritja e moshës mesatare, mirëqenia dhe përkujdesja fizike

e shtuar ka shtyrë kufijtë e moshës së tretë, duke e bërë më eufemistike narrativën për pleqërinë dhe për afrimin e fundit të jetës tokësore: “Kulti i të riut dhe i rinisë: gjëja më e largët nga vdekja”¹. Narrativa e mirëqenies, e rinisë së përhershme dhe e nevojës për performancë edhe në moshë të shtyrë është një nga strategjitë kulturore e shoqërore që e largojnë vdekjen nga diskursi i përditshëm, duke nxitur përdorimin e formave eufemistike për ta emërtuar atë.

Një tjetër formë e rëndësishme narracioni përftohet në rrafshin gjuhësor përmes shprehjeve eufemistike: fjala *vdekje* zëvendësohet nga shprehje që krijojnë një distancë emotive nga ngjarja e padëshiruar. Çepani – Marteta pohojnë se këto qëndrime që shprehen përmes rrafshit ligjërimit janë mekanizma mbrojtës individualë e shoqërorë: “Ato përdoren nga individë dhe shoqëri për të trajtuar tema delikate ose të diskutueshme, për të ruajtur mirësjelljen, për të treguar ndjeshmëri kulturore, për të zbutur realitetet e pakëndshme dhe, në disa raste, për të maskuar natyrën e vërtetë të diçkaje”².

Kësisoj eufemizmat në përgjithësi dhe disi më shumë eufemizmat për fundin e jetës janë dëshmi e një ndjeshmërie të rrënjësuar në shoqëritë njerëzore në lidhje me argumentin. Vdekja përjetohet me frikë kudo ndër njerëzit dhe siç shprehet Messori: “ndodh si në Lindje, si në Perëndim, ndër komunistë e kapitalistë, në botën ‘e parë dhe në botën ‘e dytë, në pritje që fshehja dhe mohimi i vdekjes (...) të eksportohen edhe në botët e ‘treta’ e të ‘katërta’, të cilat deri diku i mbeten besnikë një mençurie të lashtë”³.

Pavarësisht se Lindja dhe Perëndimi e përjetojnë vdekjen njëllë me frikë, ngurrim dhe mohim, vlen të hetohen edhe veçantitë e konteksteve lokale. Ndryshimet shoqërore dhe kulturore imponojnë sjellje të ndryshme kundrejt dukurive që deri dje ishin tabu: “[...] rregullat ndaluese për të folur për seksin dhe për funksionet gjenitale tani janë zhvendosur mbi vdekjen dhe të vdekurit”⁴. Frika për vdekjen ka ushqyer qysh herët njerëzimin me idenë e mbrojtjes prej vdekjes dhe prej të vdekurve, sidomos nëse këta kishin pasë famë të keqe në të gjallë të tyre. Valentino Nizzo në përmbyllje të Kuvendit për Arkeologjinë e Vdekjes në Iliri dhe në Epir⁵ pohon se frika

1 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte. La proposta cristiana: illusione o speranza*, Edizioni SEI, Torino 2001, 46.

2 A. ÇEPANI – R. MARTETA, *Arti i eufemizmeve të shqipes: një vështrim për anën semantike-leksikore dhe formimin e tyre*, in *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 77.

3 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 23.

4 *Ibid.*, 23.

5 V. NIZZO, *Riflessioni conclusive a margine del convegno sull'archeologia della morte in Illiria ed Epiro*, in G. LEPORÉ – B. MUKA (ed.), *Archeologia della morte in Illiria ed Epiro. Contesti, ritualità e immagini tra età ellenistica e romana*, Quasar, Roma 2020, 587.

për kthimin e të vdekurve ishte premisa për zhvillimin e praktikave dhe besimeve që shërbenin si parandalim për rikthimin e të vdekurve, që në jetë kishin dëshmuar sjellje të liga. Disa nga këto praktika janë mjaft të rrënjësura në Ballkan, sidomos në traditën folkloristike që vërtitet rreth tipologjisë “jo të vdekur”⁶. Kjo na sjell ndër mend shprehjen “u ngri / u çua lugat”, hershmërinë e së cilës nuk mund ta dokumentojmë, por figura e lugatit e përafruar edhe në fjalorë të gjuhës shqipe me figurën e vampirit i afrohet përfytyrimit që Nizzo dëshmon në shkrimin e tij, për “jo të vdekurit”.

“Frika për të vdekurit (...) është një temë mjaft e përhapur në rrafsh etnografik, rrjedhojat e së cilës janë të identifikueshme në një mori praktikash përmes të cilave veprohet brenda kornizës tipike të ritit apo edhe jashtë saj, nga të mbijetuarit për të zhbërë veprimtarinë e të vdekurve dhe për të penguar rikthimin e tyre”⁷.

Mënyrat e emërimit të vdekjes kushtëzohen nga besimet, ritualet dhe përfytyrimet e folësve, të cilat përkthehen në rrafsh gjuhësor. Një kontribut të vyer për ritualin e vdekjes në kontekstin shqiptar ka dhënë i Lumi Aleksandër Sirdani që në vitin 1928⁸. Lënda e veprës së tij është e pasur dhe e paraqitur në një strukturë të thjeshtë, që mbështetet në fjalën si gjymtyrë organizuese, e cila gjeneron njësi frazeologjike. Përveç mbledhjes së lëndës etnografike (vajtimi, gjama), Sirdani ka bërë dhe shënime të natyrës antropologjike, si në rastin e vajtimit të një banori mysliman të Reçit nga një grua katolike prej Shkrelit: “Tue kënë kto male të Reçit e të Lohes të perzëm Kristjan e mohamedan, ndollë qi e kshtëna vajton mohamedanin, e bulla të kshtenin si të ju ndollin rasa e gjaku qi kanë bashkë”⁹.

Punimi ynë mëton analizën e aspektit gjuhësor të eufemizmeve për vdekjen në gjuhën shqipe dhe të trajtimit të tyre si njësi kulturore të qëndrueshme në kontekst shqiptar, bartëse të ideve, praktikave, qëndrimeve, sjelljeve dhe simbolikave. Të parë nën këndvështrimin e semantikës leksikore, eufemizmat trajtohen si njësi që mundësojnë zëvendësimin e emërimit të drejtpërdrejtë përmes metaforizimit, perifrimit ose zhvendosjes kuptimore, ndërsa në rrafshin frazeologjik ato paraqiten si njësi të qëndrueshme shumëfjalëshe me strukturë të ngulitur ose pjesërisht të ngulitur. Në kuadrin e gjuhësisë konjitive, mbështetur në teorinë e metaforave konceptuale, vdekja paraqitet si largim, gjumë, kalim në një botë tjetër ose ndërprerje e funksioneve jetësore. Krahas këtyre qasjeve, në këtë punim merret në shqyrtim edhe aspekti strukturor-formal i eufemizmeve. Analiza e modeleve ndërtimore lejon të vërehen mënyrat

6 *Ibid.*, 588.

7 *Ibid.*, 589.

8 I Lumi ALEKSANDËR SIRDANI, *Fjalë ari*, Botime Françeskane, Shkodër 2024 (botimi i parë në vitin 1928).

9 *Ibid.*, 250.

tipike me të cilat realizohet zbutja e shprehjes së vdekjes në gjuhën shqipe, duke treguar se struktura leksiko-gramatikore lidhet ngushtë me motivimin semantik dhe me përfytyrimet kulturore që shoqërojnë këtë dukuri. Krahas analizës gjuhësore dhe shqyrtimit të përfaqësimit të vdekjes përmes metaforës konceptuale, u pa e nevojshme që ky artikull të mbështetet në një korpus gjuhësor me shembuj konkretë nga burime të ndryshme. Analiza morfologjike dhe strukturore e njësive të mbledhura – duke dalluar njësitë njëfjalëshe dhe ato shumëfjalëshe, si dhe realizimet konkrete me vlerë foljore, emërore ose mbiemërore – ndihmojnë në evidentimin e modeleve ndërtimore që përsëriten me një shpeshtësi të caktuar në gjuhën shqipe.

Për këtë studim është ndërtuar një korpus prej rreth 80 njësish leksikore dhe shprehjesh frazeologjike, i mbledhur nga burime leksikografike dhe studimore të shqipes, si fjalorë të përgjithshëm, fjalorë frazeologjikë, studime gjuhësore dhe materiale të traditës popullore. Ky material ka shërbyer si bazë për analizën gjuhësore dhe kulturore të eufemizmave, si edhe për klasifikimin e tyre sipas tipareve semantike, strukturore dhe funksionale¹⁰. Për të dalluar grupet kryesore semantike (vdekja si largim, si gjumë, si kalim në botën tjetër, si ndërprerje e jetës etj.), është bërë një klasifikim semantik i eufemizmave. Analiza konceptuale dhe pragmatike e njësive të korpusit e plotëson punimin me vëzhgime të natyrës antropologjike-kulturore që lidhen me përfytyrimin e përgjithshëm për vdekjen, si dhe me mënyrat e përpunimit të këtij përfytyrimi në funksion të marrëdhënieve dhe ndërveprimeve shoqërore. “Nëse një gjuhë ka apo jo terma të qartë për të shprehur realitete institucionale, ky është një test konceptualizimi. [...] gjuha përmban në sistemin e saj një përshkrim të përgjithshëm dhe klasifikim të situatave të ndryshme të ligjërimeve të mundshme, si dhe udhëzime për sjelljen gjuhësore, që do të thotë se specifikon disa lloje të ndikimit që mund të ushtrohen duke folur, si dhe disa role që mund t’i japim vetes ose t’ua imponojmë të tjerëve nëpërmjet të folurit”¹¹. Përdorimi i eufemizmave nuk është vetëm zgjedhje stilistike, por pjesë e normave të sjelljes gjuhësore të përcaktuara nga sistemi i gjuhës dhe nga kultura.

Korpusi synon të paraqesë larminë e mekanizmave eufemistikë në shqipe, si metaforizimi (p.sh. *u shua, u largua, ra në gjumë të përjetshëm*), përdorimi i shprehjeve frazeologjike (*ndërroi jetë, u nda nga jeta*), si dhe përdorimi i formave që shprehin qëndrime të lidhura me besimin dhe

10 A. KOSTALLARI et al., *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë 1980; M. IBRAHIMI, *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*, Shkup 2009; E. ÇABEJ, *Disa eufemizma të shqipes*, in *Studime gjuhësore*, IV, Prishtinë 1978.

11 A. DOJA, *Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Kristalina-KH, Tiranë 2018, 313-314.

përkatësinë fetare (*shkoi te Zoti, u thirr nga Perëndia*). Krahës tyre, në korpus përfshihen edhe njësi të motivuara kulturalisht nga paganizmi dhe tabutë gjuhësore, të cilat dëshmojnë dhe në traditën popullore me shprehje si: *gjumi â gjysa e dekës* ose *gjumi â pasqyra e dekës*, të cilat sjellin përfytyrimin e gjumit si një gjendje e ndërmjetme midis jetës dhe vdekjes, duke e bërë më të pranueshëm konceptin e fundit të jetës përmes një metafore që e zbut dhe e afron me përvojën e përditshme njerëzore.

2. Dëbimi i vdekjes me fjalë

Qasja bashkëkohore priret drejt dëbimit të fjalëve të drejtpërdrejta për vdekjen. Kjo qasje ndaj ngjarjes që shënon përfundimisht sosjen e ciklit të jetës, me fjalët e Vittorio Messori-t është një qëndrim hipokrit dhe sipërfaqësor ndaj vdekjes: “ ..., sepse e njëjta kulturë që ka shkaktuar vdekjen e shumë njerëzve gjatë shekullit të fundit – kujtojmë këtu gjenocidet, Holokaustin, bombën atomike – është po ajo kulturë që tregohet jashtëzakonisht e kujdesshme për të shmangur artikullimin e drejtpërdrejtë të fjalës vdekje”.¹² Kjo hipokrizi e supozuar më sipër është objekt edhe në veprën e Sigmund Freud-it *Psikanaliza e shoqërisë moderne*, ku pohohet se i ashtuquajtimi respekt për të vdekurit shpesh e tejkalon respektin për të gjallët, disi i vështirë për t’u kuptuar si i tillë pikërisht se nuk përputhet me kufijtë e së vërtetës: “Është e çuditshme se si i respektojmë të vdekurit, kur në të vërtetë ai nuk ka më nevojë për këtë respekt. Është veçanërisht domethënëse se si respekti për të vdekurit është në kontrast me mungesën e respektit për të njëjtët njerëz kur ata janë gjallë”.¹³

Madje Messori argumenton se këto shprehje që gjuhëtarët i kanë emërtuar si eufemizma janë në të vërtetë përpjekje për vetëmbrojtje dhe ikje nga frika që vdekja shkakton, duke e bërë disi më pak të besueshme tezën e respektit për të vdekurit.¹⁴ Allan & BurrIDGE pohojnë se nevoja për të shprehur koncepte të ndjeshme, që e ngarkojnë emocionalisht folësin ose bashkëfolësin, gjenerojnë strategji eufemistike për ta shmangur kumtin e drejtpërdrejtë rreth një teme tabu¹⁵. Vdekja është ndër tabutë tipike në komunikimin ndërpersonal dhe shoqëror, prandaj qasja ndaj saj prodhon një sjellje gjuhësore që parapëlqen zëvendësimet leksikore dhe frazeologjinë. Është e njohur se eufemizmat për vdekjen janë mekanizma komunikativë për të zbutur ngjarjen, për të shmangur përballjen e drejtpërdrejtë me lajmin a ngjarjen, për të rregulluar emocionet, për t’u përshtatur me

12 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 49.

13 S. FREUD, *Psicoanalisi della società moderna. Il nostro atteggiamento nei confronti della morte*, Newton, Roma 2010, 75.

14 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 49.

15 K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Euphemism and Dysphemism: Language Used as Shield and Weapon*, Oxford University Press, New York 1991, 19.

normat kulturore.¹⁶ Ndjeshmëria për vdekjen, sipas Messori-t, dëshmon anën tonë njerëzore. Ndryshe prej atyre për të cilët vdekja nuk përbën problem dhe që mund të konsiderohen “përbindësja çnjerëzore”, të gjithë të tjerët turbullohen në jetën e tyre prej dy anktheve themelore: ankthi i çmendurisë dhe ankthi i vdekjes¹⁷. Ndryshe nga ankthi i parë, i cili mund të mos verifikohet, të dytit i nënshtrohem të gjithë: “vdekja është një zakon që herët a vonë të gjithë do të duhet ta respektojmë”.¹⁸ Shprehja simotër (me atë të Borges) “Deka është hak për gjithkënd”, pjesë e thesarit folklorik-frazeologjik të shqipes mbledhur nga Aleksandër Sirdani, është dëshmi e universalitetit të ndjesisë njerëzore për argumentin¹⁹.

Allan & Burridge pohojnë se qasja ndaj vdekjes si tabu mbështetet në frikërat tona²⁰. Autorët artikulojnë disa lloje frikërash në lidhje me argumentin, si: frika për humbjen e të dashurve tanë; frika për tretjen e trupit fizik; frika për fundin e jetës; frika nga shpirtrat e këqij dhe për fatin e shpirtit të të vdekurit; frika për vdekjen si një ngjarje e pakuptimtë. Vdekja e të dashurve e gjeneron frikën për vdekjen si një ngjarje shumë të afërt me ne. Gjatë hetimit të sjelljes njerëzore ndaj vdekjes, Sigmund Freud-i kishte vënë re se në “shoqëritë e papjekura”, siç i quan ai shoqëritë primitive, po të njëjtit që nuk hezitonin të hiqnin qafe njeriun e urryer edhe duke i provokuar vdekjen, prekeshin shumë kur vdiste dikush i afërt; kjo u kujtonte atyre se njeriu zhdukej përgjithmonë prej kësaj bote dhe se vdekja ishte një ngjarje shumë e afërt.²¹ Sjellja përkundrejt vdekjes, qoftë ajo personale (e imagjinuar), e njerëzve të dashur dhe të afërt, apo e tjetrit, pra e atij që është i ndryshëm prej nesh dhe grupit të cilit i përkasim, formësohet në bazë të dinamikave kulturore e shoqërore. Për këtë arsye, hetimi i kësaj dukurie nuk mund t’i nënshtrohet një gjykimi të thjeshtë dhe të shkëputur nga konteksti, si një sintezë e urtësisë dhe e kulturës popullore²², por kërkon që ajo të kuptohet e lidhur me rrethanat që e kanë prodhuar dhe me zhvillimin e saj në kohë.

16 K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Forbidden Words: Taboo and the Censoring of Language*, Cambridge University Press, Cambridge 2006, 29-31.

17 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 31.

18 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 13.

19 I Lumi ALEKSANDËR SIRDANI, *Fjalë ari*, Botime Françeskane, Shkodër 2024.

20 K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Euphemism and Dysphemism*, 153.

21 S. FREUD, *Psicoanalisi della società moderna*, 75.

22 H. SHEHU, *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe, II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2024, 26.

3. Shprehja e dukurisë së vdekjes: procese gjuhësore dhe motive kulturore

“Fiala mort sbân” kështu shkruhet në nenin tetëdhjetë e gjashtë të librit të shtatë (<https://kanuni.org/>) të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kjo shprehje, edhe sot në përdorim dhe pjesë e thesarit kulturor të praktikave sociale, duket se e vendos njeriun në një pozicion të epërm përballë vdekjes. Fjala futet në hapësirën e vdekjes për ta kontrolluar atë. Maurice Blanchot-i, kur heton hapësirën e vdekjes në poezinë e Rilkes, e konsideron fjalën si “fuqi thelbësore për të shndërruar të dukshmen në të padukshme, fjala futet në një hapësirë të pazhbëshme, në një intimitet që domosdo jeton edhe jashtë nesh”.²³ Pavarësisht se vdekja përcaktohet universalisht si pushim i të ekzistuarit, kulturat ndryshojnë në mënyrë domethënëse për nga mënyra sesi e paraqesin gjuhësisht dukurinë. Në *Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe* vdekja përkufizohet si “ndalimi i veprimtarisë jetësore të organizmit të njeriut, ndërprerja përgjithnjë e shkëmbimit biologjik të lëndëve në organizëm a në një pjesë të tij; mbarimi a fundi i jetës së njeriut”.²⁴ Vërehet se kuptimi ndërtohet mbi tri elemente themelore semantike: *ndalimi*, *ndërprerja përfundimtare* dhe *mbarimi*. Elementi i parë, ndalimi, e paraqet vdekjen si pezullim të funksioneve jetësore; elementi i dytë, ndërprerja përfundimtare, thekson karakterin e pakthyeshëm dhe përfundimtar të këtij procesi; ndërsa elementi i tretë, mbarimi, e konceptualizon vdekjen si përfundim të një rrjedhe jetësore. Në këtë mënyrë, ndalimi i veprimtarisë jetësore shënon kufirin ndërmjet jetës dhe vdekjes, duke shprehur fuqinë semantike të kësaj dukurie, e cila paraqitet si një koncept absolut, që nuk njeh shkallëzim në kalimin nga jeta në vdekje. Pikërisht përmes këtyre tre përbërësve ndërtohet gjuhësisht ideja e pakthyeshmërisë së dukurisë, duke e paraqitur vdekjen si një ndërprerje përfundimtare dhe të pakthyeshme të procesit jetësor. Megjithatë, në përdorimin e përditshëm gjuhësor të shumë kulturave, ky karakter absolut i vdekjes shpesh zbutet përmes strategjive të ndryshme gjuhësore, përmes shmangieve leksikore, sidomos përmes metaforizimit dhe eufemizmit, të cilat e paraqesin vdekjen jo si ndërprerje të menjëhershme, por si largim, gjumë, kalim ose ndarje. Kjo tregon se vdekja përpunohet në gjuhë edhe si dukuri kulturore dhe diskursive, ku nevoja për ta bërë më të pranueshme një përvojë të pakthyeshme çon në krijimin e një numri të madh formash alternative të emërtimit. Sa më e madhe sasia e eufemizmeve dhe shumëllojshmëria e tyre për të shmangur fjalën e drejtpërdrejtë për vdekjen, aq më shumë përforcohet ideja e tabusë në lidhje me dukurinë. Philip Aries-i do të

23 M. BLANCHOT, *Lo spazio letterario*, Il Saggiatore, 2018, 147.

24 <https://fjalori.online/?search=vdekje&mode=exact>

thoshte se kjo është pika në të cilën vdekja bëhet “e pathënshme”²⁵. Në studimin e tij që përbën një referencë të pashmangshme për argumentin *Essais sur l'histoire de la mort en Occident*, ai vë në dukje se Përdimi i nënshtrohet modernitetit ku vdekja kthehet në një entitet që nuk mund të përmendet, bëhet e “paemër”: Zhdukja e emërimit pasqyrohet në rrafsh gjuhësor dhe nxit prodhimin dhe përhapjen e eufemizmave, duke i kthyer ato në një instrument gjuhësor me fuqi simbolike.²⁶

Sipas Çepanit – Martetës²⁷, përdorimi i këtyre eufemizmave mund të ndihmojë në lehtësimin e përmendjes së vdekjes për njerëzit dhe në shfaqjen e ndjeshmërisë ndaj të pikëlluarve për humbjen e tyre”. Studiueset kanë identifikuar një përfaqësim domethënës gjuhësor të eufemizmave për vdekjen, nisur nga paraqitja e temave semantike: largimi nga jeta dhe kujtimi i të vdekurit; emërtimi i të vdekurit; emërtimi i vdekjes, varrit, varrimit, mospërfillja për të vdekurin dhe largimi nga jeta; mallkimet për të gjallët në lidhje me vdekjen e tyre të mundshme; përmendja e jetës së përtejme etj.²⁸ Përfshirja emocionale e të mbijetuarve nxit aftësitë krijuese që përmes shprehjeve gjuhësore përcaktojnë diskursin rreth dukurisë dhe motivet kulturore që qëndrojnë në bazë të tij.

3.1. Klasifikimi semantik i eufemizmave

Për të analizuar në mënyrë sistematike eufemizmat që përdoren për konceptin e vdekjes, është i nevojshëm një klasifikim semantik, që do të ndikonte në organizimin e materialit sipas strategjive kryesore të ndërtimit të kuptimit. Në këtë kuadër mund të dallohen disa grupe eufemizmesh, të përcaktuara nga mekanizmat shprehës që përdoren në formimin e tyre, si metaforizimi dhe përdorimi i shprehjeve frazeologjike. Sipas Allan & Burridge (2006), metafora është një nga strategjitë më të zakonshme në krijimin e eufemizmave. Struktura e qëndrueshme e metaforave dhe e njësive frazeologjike shërben si mjet për ruajtjen dhe përcjelljen e përvojës kulturore dhe të qëndrimeve kolektive ndaj dukurive të ndjeshme, si vdekja dhe ritet që lidhen me të. Metafora e vdekjes që paraqitet si gjumë, ndër më të përhapurat në përvojën njerëzore, e paraqet këtë dukuri jo si një ndërprerje përfundimtare dhe kërcënuese, por si një gjendje të afërt me përvojat e zakonshme të jetës së përditshme, duke krijuar kështu një efekt zbutës dhe ngushëllues. Kjo strategji gjuhësore e afron vdekjen më shumë me idenë e pushimit sesa me atë të një fundi të pakthyeshem: *fle gjumin e vdekjes; gjumi i madh; bie në gjumë të përjetshëm, pushimi i pasosun*. Lakoff

25 PH. ARIÈS, *Storia della morte in Occidente*, Rizzoli, Bur 1978, 75.

26 *Ibid.*, 78.

27 A. ÇEPANI – R. MARTETA, *Arti i eufemizmave të shqipes*, 85.

28 *Ibid.*, 83-84.

& Johnson theksojnë se metafora nuk është zbulurim stilistik, por një mekanizëm i strukturimit konceptual²⁹. Në këtë kuptim, metafora e gjumit funksionon si mohim simbolik i përfundimit absolut, duke e paraqitur vdekjen si gjendje pushimi, jo si ndërprerje. Vdekja paraqitet si kalim, udhëtim: *ndërroi jetë; shkoi në botën tjetër; u nda këso bote*.

3.1.1. Konceptimi i vdekjes, i realizuar përmes metaforave dhe shprehjeve të qëndrueshme, nuk shfaqet vetëm në planin semantik, por materializohet në disa nivele të organizimit gjuhësor. Për këtë arsye, analiza e eufemizmeve kërkon shqyrtimin e tyre në tre rrafsh kryesore: leksikor, morfosintaksor dhe pragmatik.

a. Në rrafshin leksikor, një nga dukuritë më domethënëse që vërehen në njësitë e shqipes është zëvendësimi leksikor, i cili shfaqet në shmangien e formës së drejtpërdrejtë *vdiq* dhe përdorimin në vend të saj të njëjësive: *ndërroi jetë, shkoi, na la, prehet, mbylli sytë, hyri në dhe* etj. Koncepti që nuk emërtohet drejtpërdrejt zëvendësohet me ndërtime të tjera, të cilat e zbusin kuptimin dhe e bëjnë më të pranueshëm. Kjo dukuri nuk është e kufizuar vetëm në shqipe, por është e pranishme edhe në gjuhë të tjera. Allan & Burridge (2006)³⁰ e shpjegojnë shmangien e emërtimeve të drejtpërdrejtë si pasojë e tabusë që lidhet me këtë argument, duke e konsideruar eufemizmin si një strategji të zakonshme gjuhësore për trajtimin e dukurive të ndjeshme. Po kështu dhe Messori (1982)³¹, i cili flet për “heshtjen kulturore” mbi vdekjen: sipas tij shmangia e termit të drejtpërdrejtë krijon idenë e një dëbimi simbolik të vdekjes nga diskursi i zakonshëm.

Dallohen gjithashtu fusha të ndryshme leksikore që shërbejnë për zëvendësimin e emërtimeve të drejtpërdrejtë, si leksiku religjioz (*shkoi te Zoti, u thirr nga Perëndia, prehet në paqe*) dhe leksiku teknik-burokratik, i cili e paraqet dukurinë në mënyrë neutrale dhe të institucionalizuar (*vdekje klinike, ndërprerje e funksioneve jetësore* etj.).

b. Në rrafshin morfosintaksor, zbutja e emërtimeve të vdekjes realizohet përmes ndërtimeve sintaksore që shmangin referimin e drejtpërdrejtë të veprimit dhe të subjektit. Një dukuri e shpeshtë është përdorimi i formave të emëruara, të cilat nuk e përqendrojnë vëmendjen tek ajo që ka ndodhur, pra te vdekja, por e paraqesin personin përmes një cilësimi ose gjendjeje, si në rastet: *i mjeri, i shkreti, i ziu, qyqari, i shuari*.

Një tjetër mjet i rëndësishëm është përdorimi i formave foljore

29 G. LAKOFF – M. JOHNSON, *Metaphors We Live By*, University of Chicago Press, Chicago 1980.

30 K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Forbidden Words*, 2006.

31 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 2001.

joveprorre, të cilat shmangin përmendjen e drejtpërdrejtë të foljes *vdiq*. Në vend të saj përdoren ndërtime si: *u nda nga kjo jetë, u bë për vig, u bë për rahmet, u martua me gurë e dhe, u martua me dheun e zi, u nda kësaj bote*.

Këto forma e zhvendosin vëmendjen nga akti i vdekjes te personi, duke krijuar një efekt zbutës dhe emocional, që shmang përballjen e drejtpërdrejtë me karakterin përfundimtar të vdekjes.

c. Në rrafshin pragmatik, vëmendja përqendrohet në mënyrën se si komunikohet vdekja dhe në strategjitë diskursive që përdoren për ta zbutur ose për ta shmangur emërtimin e saj të drejtpërdrejtë. Në këtë kuadër, vërehet përdorimi i një grupi foljesh që shprehin qëndrime të caktuara ndaj dukurisë, si *hesht, mohoj, fsheh*, të cilat ndërtojnë modele konceptuale për të përshkruar ndërveprimin midis ligjërimit dhe vdekjes. Këto i kemi quajtur ‘folje të qëndresës’, sepse fusha e tyre semantike sugjeron procese që synojnë të shmangin, të kontrollojnë ose të mbrojnë nga vdekja.

Në këtë kuptim, *heshtja* shfaqet si shmangie e emërtimit të drejtpërdrejtë, *mohimi* si neutralizim i përfundimit, ndërsa *fshehja* realizohet përmes zhvendosjes semantike, si në shembujt *pavdekësi, vdekje klinike, kthetrat e vdekjes*. Semantika që sugjeron fshehje, mohim, shmangie të një dukurie që e zhbën forcën dhe vitalitetin e njeriut mund të jetë instrument kontrolli ideologjik në sisteme që e mbështesin pavdekësinë, fuqinë fizike, supernjeriun. Albert Nikolla vë në dukje se kundërvënies midis “njeriut të ri” dhe “njeriut të vjetër” shfaqet për herë të parë në revistën *Rruga e Partisë* (1954).³² Sipas tij, “njeriu i ri” paraqitet si modeli i qytetarit socialist, i shëndetshëm fizikisht dhe ideologjikisht, i çliruar nga besimet e vjetra dhe nga ndikimet fetare.³³ Fushata e hapur kundër fesë në vitet ’60 dhe përpjekja për të zhdukur çdo shenjë të botëkuptimit tradicional ndikuan edhe në kufizimin e ligjërimit për dukuri që lidhen me besimin, ritualin dhe jetën pas vdekjes. Në këtë kuptim, prirja për ta shmangur ose për ta trajtuar në mënyrë të tërthortë temën e vdekjes mund të ketë ndikuar edhe në mungesën e studimeve të mirëfillta për eufemizmat që lidhen me të. Një tezë të ngjashme mbështet edhe Rafaela Marteta kur shkruan për qasjen ndaj temës së vdekjes në librin “Letra grues seme të vdekun”: “tematika e librit shkund një mendësi komuniste e post-komuniste mjaft të ujitur me virtytin e njeriut të fortë, shëndetplotë, të fuqishëm e deri gati të pavdekshëm, për aq kohë sa tema e vdekjes në krijimtarinë tonë letrare ishte e papërputhshme me arritjet socialiste, planet pesëvjeçare; ku njeriu nuk kishte kurrfarë tutet e kurrfarë pikëpyetjet për fillimin e

32 A. NIKOLLA, *Njeriu i ri shqiptar: ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit*, Onufri, Tiranë 2012, 51.

33 *Ibid.*, 80.

fundin e tij; e megjithatë, një njeri që ka nevojë me u kurue”.³⁴ Kjo tezë është mbështetur në pohime të studiuesve që e kishin identifikuar herët mungesën e simpatisë për trajtimin e temës së vdekjes nga filozofitë me frymëzim marksist, “marksizmi i ngulitur i bllokut sovjetik, por edhe nga marksizmat e tjerë perëndimorë”³⁵. Funksioni semantik dhe pragmatik i këtyre formave bëhet edhe më i dukshëm kur vdekja paraqitet si një agjent veprues, si një kundërshtar ndaj të cilit duhet bërë rezistencë, si në shprehjet: *i bën dredha vdekjes, nuk i trembet vdekjes, e mori vdekjen në sy*. Në këto raste, vdekja nuk paraqitet si një pësim i thjeshtë, por si një forcë që sfidohet, gjë që aktivizon përdorimin e metaforave që funksionojnë si një lloj mburoje semantike ndaj realitetit të drejtpërdrejtë. Xhevat Lloshi e modelon folësin, kumtuesin e shprehjes në bazë të përzgjedhjes që ky/kjo bën për eufemizmat, sipas rastit: “ton solemn” kur përdor eufemizma librorë; “ton intim të ngrohtë” kur përdor ndërtime si *na la, na iku*; ton të rëndë kur thuhet *e drodhi këmbën; ngordhi; i ktheu potkonjtë diellit*.³⁶

Disa shprehje, që janë tejet kontekstuale (vendase), si: *dorëzoi tallonin, dorëzoi triskën* nxitin një shqyrtim të pashmangshëm e madje të volitshëm të funksionit pragmatik. Për të njëjtat shprehje, Artur Lamaj vëren funksioni i gjymtyrës së varur, e ndryshme nga njëra shprehje në tjetrën, dëshmon se eufemizmat janë “risemantizuar” në bazë të periudhave të ndryshme të zhvillimit ekonomik-shoqëror të bashkësisë shqiptare³⁷.

Nisur nga përmbajtja e tyre mund të hamendësohet se pasqyrojnë një praktikë që ka nisur përgjatë viteve të regjimit si rrjedhojë e dispozitave politike-institucionale për racionimin e ushqimit. Konteksti pragmatik sugjeron një lloj “modeli semantik mendor”³⁸ për ta lexuar këtë situatë komunikative. Përmasa pragmatike e diskursit nuk mund të mos shoqërohet nga konsiderata të natyrës ideologjike, pavarësisht se lidhja mund të mos jetë e drejtpërdrejtë: “[...] ne gjithashtu njohim aspektet socio-konjitive të marrëdhënieve të ideologjisë me diskursin, sesi mund të shprehen dhe të aktualizohen në diskurs dhe sesi mund të përftohen dhe të ndryshohen prej tij”.³⁹ Më herët Benveniste kishte shkruar për rëndësinë e situatës komunikative, që sipas tij është deri përcaktuese për përdorimin e përshtatshëm të eufemizmit: “Është pikërisht situata komunikative ajo që e modifikon llojin e shprehjes eufemistike, në përputhje jo vetëm

34 R. MARTETA, *Letra grues seme të vdekun*, “Shêjzat” III (2018), 1-2, 131-134.

35 V. MESSORI, *Scommessa sulla morte*, 2001, 36.

36 XH. LLOSHI, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, shblu 2001, 185.

37 A. LAMA, *Pasuri të ligjërit shqip II*, Akademia e Studimeve Albanologjike 2021, 198.

38 T. VAN DIJK, *Discourse and ideology*, in T. A. VAN DIJK (ed.), *Discourse and ideology*, London, SAGE Publications, 2011, 392.

39 *Ivi*.

me rregullat gjuhësore, por edhe me normat morale dhe shoqërore”.⁴⁰ Këto komponente pasurojnë procesin e “pasurimit pragmatik”: “Ky pasurim pragmatik ndodh jo thjesht përmes asaj që është komunikuar drejtpërdrejt në thënie, por sidomos prej deduksioneve të bëra në bazë të informacioneve jo të drejtpërdrejta dhe sfondit konceptual të kuadrit semantik që zotërohet natyrshëm nga lexuesi, pjesë e një kulture dhe formimi të caktuar”.⁴¹ Tzvetan Todorov e mvesh me rol themelor “aktin ligjërimit”,⁴² siç janë eufemizmat, kur ai realizohet brenda një situatë komunikative që ndërton historinë e ligjërimit.

3.1.2. Analiza në rrafshin leksikor, morfosintaksor dhe pragmatik tregon se eufemizmat që përdoren për vdekjen nuk ndryshojnë vetëm në formë, por edhe në mënyrën se si e konceptualizojnë dukurinë. Për këtë arsye, është i nevojshëm edhe një klasifikim sipas përmbajtjes semantike të shprehjeve eufemistike, i cili bën të mundur dallimin e disa grupeve kryesore kuptimore.

- Një grup shprehjesh tregojnë gjendjen e dikujt që është afër vdekjes, duke e paraqitur fundin si një ngjarje të afërt, por ende të parealizuar, si në rastet: *me një këmbë në varr, në buzë të varrit, me shpirt ndër dhëmbë*. Këto shprehje e paraqesin vdekjen si një kufi që po afrohet, duke shmangur emërtimin e saj të drejtpërdrejtë.

- Një grup tjetër e paraqesin vdekjen si pushim të funksioneve biologjike, duke e përshkruar atë përmes ndërprerjes së veprimtarive jetësore: *e la zemra, harroi të merrte frymë, mbylli sytë (përjetë)*. Në këto raste, vdekja konceptualizohet si ndalim i funksioneve fiziologjike, në përputhje me përkufizimin e saj, por e shprehur në mënyrë të zbutur.

- Një kategori më vete janë shprehjet që emërtojnë personin e vdekur, si *buzëlidhuri, emërshuari, qafëthyeri* etj., të cilat janë zakonisht ndërtime njëfjalëshe, kryesisht kompozita të emërzuara, të cilët në këto përdorime nuk tregojnë më një cilësi, por shërbejnë për të emërtuar personin e vdekur të karakterizuar nga kjo cilësi.

- Një grup i rëndësishëm përfshin shprehjet që e paraqesin vdekjen si kalim në një jetë tjetër, si në rastet: *ndërroi jetë, ndërroi shtëpi, shkoi në jetën e vërtetë*. Ky konceptim lidhet me besimin në vazhdimësinë e ekzistencës pas vdekjes dhe ka rrënjë të thella në traditën kulturore. Antropologu Mark Tirta vëren se shumë prej shprehjeve eufemistike në kulturën shqiptare

40 E. BENVENISTE, *Problemi di linguistica generale*, Il Saggiatore, Milano 2010, 362.

41 T. PLANGARICA, *Shkencat e ligjërimit dhe diskursi letrar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë 2026, 202.

42 T. TODOROV, *Struttura profonda dell'enunciazione*, in *Teorie del simbolo*, Garzanti, Milano 2008, 399.

mbartin gjurmë të paganizmit⁴³. Në ritualet e vdekjes, marrëdhënia midis të vdekurit dhe tokës zë një vend të veçantë, pasi dheu shihet si hapësira ku i vdekuri pranohet dhe gjen prehje. Shumë rituale gjatë funeralit i bëhen dheut / tokës, në mënyrë që të jetë miqësore me të sapovdekurin dhe këtë e dëshmon edhe ekzistenca e eufemizmave: *u martua me gurë e dhe, u martua me dheun e zi*. Siç vëren Rutschowskaya, “për njerëzit e vdekur toka është një hapësirë ku lënda pushon në paqe, kurse varri është një mënyrë për të lidhur të vdekurin me njerëzit e gjallë”⁴⁴.

3.2. Klasifikimi leksiko-gramatikor i eufemizmave

Përveç klasifikimit semantik, eufemizmat mund të shqyrtohen edhe nga pikëpamja e ndërtimit apo e strukturës leksiko-gramatikore, si edhe nga pasuria sinonimike, që përbën një tipar të veçantë të sistemit leksikor të shqipes në këtë fushë.

3.2.1. Duke u mbështetur në tiparet formale të ndërtimit, eufemizmat mund të ndahen në dy grupe kryesore: njësi njëfjalëshe (*gojëhapuri, i shkreti, i shuari, i ziu, ftohem, hovi, mbaroi, prehet, shkoi* etj.) dhe njësi shumëfjalëshe (*bie në gjumë të përjetshëm, e la zemra, e përcollën në botën tjetër, harroi me marrë frymë, mbylli sytë, ndërroi jetë, u nda kësaj bote* etj.).

Përkatësia në njërën ose tjetrën kategori nuk është gjithmonë e prerë, megjithatë vihet re se shumica e eufemizmave me vlerë emërore janë njëfjalëshe, ndërsa ndërtimet shumëfjalëshe paraqiten kryesisht me vlerë foljore, përjashtuar disa grupe emërore, si: *gjumë i përjetshëm, gjumi i madh, dita e të vdekurve, engjëll i Parajsës*. Kjo lidhet me faktin se, në shumë raste, zbutja e emërtimit realizohet përmes strukturave që e paraqesin vdekjen si veprim, si gjendje ose si kalim, dhe jo si një fakt i drejtpërdrejtë.

- Një pjesë e madhe e eufemizmave **njëfjalësh** janë fjalë të përbëra (kompozita), si: *emërshuari, gojëhapuri, krahëthati, qafëthyeri*. Në këto formime, elementi i parë është zakonisht një emër që shënon një pjesë të trupit (*buzë, gojë, krah, qafë*), ndërsa elementi i dytë është një mbiemër, shpesh prejpjesor (*lidhur, shuar, hapur, thyer*). Valter Memisha i konsideron mbiemrat prejpjesorë si mishëruesit më të plotë të procesit të mbartjes së sinonimisë nga një temë fjalëformuese në fjalë të tjera të krijuara prej saj.⁴⁵ Këta mbiemra janë emërzuar dhe qëndrojnë ndërmjet emrave të qëndrueshëm dhe atyre kontekstualë. Në këto raste “Duke kaluar në

43 M. TIRTA, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2004, 224.

44 M.-H. RUTSCHOWSCAYA, *Morte e sopravvivenza in Egitto*, in *Grande dizionario delle religioni M-Z*, Cittadella editrice – Edizioni Piemme, Casale Monferrato – Assisi 1988, 1432.

45 V. MEMISHA, *Nëpër hapësirat semantike të fjalës shqipe*, Tiranë 2010, 18.

klasën e emrave, mbiemrat nuk emërtojnë më cilësi të sendeve, por veta ose sende”⁴⁶ dhe cilësia nuk shërben më për të përshkruar një tipar të përkohshëm, por për të shënuar një gjendje përfundimtare.

Në eufemizmat njëfjalësh të formuar nga foljet vihet re se ato përdoren kryesisht në vetën e tretë të numrit njëjës dhe zakonisht në kohën e kryer të thjeshtë (*shkoi, mbaroi, iku, përfundoi*). Përdorimi i vetës së tretë lidhet para së gjithash me karakterin referencial të këtyre shprehjeve, pasi në shumicën e rasteve vdekja përmendet për një person tjetër dhe paraqitet në mënyrë narrative. Koha e kryer e thjeshtë është pikërisht ajo që shërben për të treguar një veprim të përfunduar në të kaluarën⁴⁷ dhe përdorimi i saj shpreh në mënyrë të tërthortë pranimin si fakt i kryer se vdekja ka ndodhur dhe tashmë i përket së kaluarës. Një pjesë e këtyre foljeve përdoret në diatezën mesore ose vetvetore (*ftohet, prehet, ishte fjetur*), duke e paraqitur veprimin si një proces që ndodh pa një veprues të jashtëm të shprehur. Në këtë mënyrë shmanget referimi i drejtpërdrejtë të vdekjes dhe krijohet një efekt zbutës, tipik për shprehjet eufemistike.

- Eufemizmat shumëfjalësh përbëjnë pjesën më të madhe të korpusit dhe janë kryesisht grupe foljore të mbështetura në metafora, si: *bie në gjumë të përjetshëm, e la zemra, mbylli sytë, u nda kësaj bote, shkoi në jetë të vërtetë, u martua me gurë e dhe*. Këto ndërtime shërbejnë për të shmangur emërtimin e drejtpërdrejtë të vdekjes dhe pasqyrojnë njëkohësisht përfytyrime kulturore, fetare dhe emocionale të folësve.

Numri më i madh i këtyre njësive përbëhet nga grupe foljore, ndërsa vetëm një pjesë e vogël janë grupe emërore. Këta të fundit zakonisht e emërtojnë vdekjen si dukuri, si në rastet: *gjumë i përjetshëm, gjumi i madh, vdekje e bardhë, rojet e qiellit, dita e të shuemve*. Këto ndërtime përbëhen nga një emër që shërben si kokë e grupit emëror (*gjumë, ditë, vdekje, roje*) dhe nga fjala përcaktuese, që zakonisht është mbiemër (*i përjetshëm, i madh, e bardhë*) ose më rrallë emër në rasën gjinore (*e qiellit*), që në ndonjë rast vjen prej një mbiemri të emërzuar (*e të shuemve*). Pjesa tjetër e eufemizmeve shumëfjalësh përbëhet nga grupe foljore që përfaqësojnë pothuajse 90% të eufemizmeve të formuar me grupe fjalësh.

Duke u mbështetur edhe në kuptimin leksikor themelor të foljes *shkoj*, vërejmë se tetë prej këtyre eufemizmeve foljorë kanë si kokë pikërisht këtë folje: *shkoi në atë jetë, shkoi për thana, shkoi me të shumtit, shkoi në jetë të vërtetë, shkoi si qeni në rrush* etj.

Përdorimi i kësaj foljeje lidhet me kuptimin e saj kryesor, atë të lëvizjes ose të kalimit nga një vend në një tjetër, i cili në këto shprehje nënkupton kalimin nga jeta në vdekje. Në këtë mënyrë vdekja conceptualizohet si

46 F. AGALLIU et al., *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I Morfologjia*. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Tiranë 2002, § 3.8.6.

47 *Ibid.*, § 7.3.7.

largim, udhëtim ose kalim në një botë tjetër, duke u shmangur emërtimi i saj i drejtpërdrejtë.

Ashtu si tek eufemizmat njëfjalësh, edhe këtu vërehen shembuj ku si fjalë përcaktuese shërbejnë fjalë që emërtojnë pjesë ose organe të ndryshme të trupit të njeriut: *e ka njërën këmbë në varr, i bëri këmbët baraj, i bëri këmbët big, ktheu krahët, ktheu sytë nga dielli, mbylli sytë, e la zemra, iu ndal zemra, drita e syve iu ka errë*.

Shpesh, si pjesë e këtyre njësive shumëfjalëshe përdoret fjala *këmbë*, duke iu referuar funksionit të saj si gjymtyrë që shërben për të ecur ose për të qëndruar (*me njërën këmbë në varr*), por edhe pozicionit të saj në trupin e pajetë (*këmbët e ftohta*). Në të njëjtën mënyrë mund të shpjegohet edhe përdorimi i fjalës *sy*, si një nga shqisat kryesore të njeriut, e lidhur me aftësinë për të parë botën përreth. Këta shembuj pasqyrojnë një metaforizim trupor të vdekjes, ku ndërprerja e funksioneve jetësore shprehet përmes referencave ndaj organeve dhe pjesëve të trupit.

Nga pikëpamja gramatikore, në këta eufemizma foljorë përdoret mënyra dëftore si mënyra tipike që shërben për të shprehur modalitetin e vërtetësisë në gjuhën shqipe⁴⁸. Më shumë se gjysma e grupeve foljore përdorin kohën e kryer të thjeshtë (*na la, ndërroi jetë, ktheu sytë nga dielli*), duke e paraqitur veprimin si të përfunduar në të kaluarën. Në disa raste përdoret koha e tashme (*bie në gjumë të përjetshëm, është në buzë të varrit*), gjë që lidhet me një mënyrë shprehjeje më të zbutur dhe më pak të drejtpërdrejtë, ku vdekja paraqitet si gjendje, proces ose kalim, dhe jo si një fakt i mbyllur në të kaluarën.

Një numër i vogël njësish e kanë foljen bërthamë në kohën e kryer, e cila në gjuhën shqipe është karakteristike për të shprehur “një veprim të përfunduar që lidhet ende me çastin e ligjërimit”⁴⁹. Me përdorimin e këtyre eufemizmeve (*drita e syve i është errur, i ka mbirë bari mbi krye*) synohet të tregohet se veprimi ka ndodhur në të kaluarën, por pasojat e tij janë ende të pranishme në çastin e ligjërimit (errësimi, mbirja e barit).

Disa eufemizma paraqiten në forma joveprore ose mesore (*u bë për vig, u nda kësaj bote, u martua me dheun e zi*), të cilat theksojnë gjendjen ose rezultatin e veprimit dhe kontribuojnë në efektin e zbutjes semantike.

Nga ana strukturore e këtyre eufemizmeve shumëfjalësh, vërehen disa modele të përsëritura, si:

folje joveprore + emër i pashquar në rasën kallëzore të paraprirë nga një parafjalë në rolin e përcaktorit kallëzuesor (*u bë për rahmet*) dhe të kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë (*u martua me gurë e dhe*);

folje veprore + emër i shquar në rasën kallëzore në rolin e kundrinorit të drejtë (*dorëzoi tallon, dorëzoi triskën, ktheu krahët, mbylli sytë, ndërroi jetë*);

48 F. AGALLIU et al., *Gramatika e gjuhës shqipe*, § 7.3.6.

49 *Ibid.*, § 7.3.7.

trajtë e shkurtër në kallëzore + folja në formën veprorë *bëj* + emër i shquar në kallëzore në rolin e kundrinorit të drejtë + emër të pashquar në rolin e përcaktorit kallëzuesor ose me përdorim ndajfoljor në rolin e rrethanorit të mënyrës (*e bëri sheshin breg, i bëri këmbët big, e bëri bishtin kopan, i bëri këmbët baraj*).

Vërehen gjithashtu disa ndërtime në të cilat trajta e shkurtër merr një rëndësi të veçantë:

trajtë e shkurtër në kallëzore + folje veprorë (*e drodhi, na la, na paska lënë*);

trajtë e shkurtër në kallëzore ose dhanore + folje veprorë + emër në kallëzore (*i lau teshat, e piu shëndetin, na la shëndetin / shëndenë*);

trajtë e shkurtër në kallëzore ose dhanore + folje veprorë + emër në rasën emërore (*e la zemra, i ndali zemra, i mbaruan ditët*).

Këto modele tregojnë se eufemizmat për vdekjen kanë një organizim sintaksor të qëndrueshëm, ku kombinimi i elementeve gramatikore shërben për të krijuar shprehje më të zbutura dhe më të tërthorta.

3.2.2. Krahës kësaj larmie ndërtimore, bie në sy edhe një pasuri sinonimike, që përbën një tipar karakteristik të sistemit leksikor të shqipes. I njëjti koncept mund të shprehet përmes formave të ndryshme, gjë që lidhet me nevojën për të zgjedhur shprehje më të zbutura, më të tërthorta ose më ekspresive, në varësi të kontekstit ligjërimor dhe të qëndrimit emocional të folësit. Kjo pasuri sinonimike shihet qartë në një varg shprehjesh që emërtojnë të njëjtin realitet përmes formave të ndryshme, si në rastet: *e la zemra / iu ndal zemra; dorëzoi tallon / dorëzoi triskën; u martua me gurë e dhe / u martua me dheun e zi; shkoi për thana / shkoi për të fituar pare; i bëri këmbët baraj / i bëri këmbët big; drita e syve iu ka errë / dritën e diellit kurrë s'ka për ta parë më; iu mbaruan ditët / iu mbarua vaji i kandilit* etj. Këto variante dëshmojnë për një larmi sinonimike, ku i njëjti referent shprehet me forma të ndryshme leksikore, shpesh me nuanca stilistike, krahinore ose kulturore të dallueshme. Ky gërshetim kuptimesh dhe funksionesh sinonimike shpie në një larmi të madhe gjuhësore në sferën e mjeteve shprehëse të gjuhës.⁵⁰

Krahës varianteve leksikore, vërehen edhe eufemizma plotësisht sinonimike që ndryshojnë nga ana strukturore, por jo nga kuptimi, si: *bie në gjumë të përjetshëm / fle gjumin e madh; buzëlidhuri, emërshuari, gojëhapuri, i mjeri, i shkreti, i ziu, qyqari, i shuari*. Këto forma, megjithëse të ndryshme në aspekt strukturor, kanë të njëjtin funksion dhe shërbejnë për të emërtuar të njëjtin realitet. Kjo shumësi sinonimike tregon jo vetëm potencialin e sistemit leksikor të shqipes, por edhe nevojën e folësve për të zgjedhur forma më të përshtatshme në varësi të kontekstit komunikativ, të situatës diskursive dhe të ngarkesës emocionale të ligjërimit.

50 SH. ISLAMAJ, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 1985, f. 49.

Përfundime

Në rastin e dukurisë së vdekjes shprehjet eufemistike nuk shprehin apo fshehin thjesht një ngjarje, por zbulojnë strategjitë që individit dhe shoqëria e përkatësisë gjejnë për ta bërë ngjarjen më të thënshme, më të lehtë. Për këtë arsye eufemizmat për temën në fjalë mund të trajtohen si letër lakmushi për të nxjerrë në dritë strategji gjuhësore (dhe bazën e tyre kulturore), për t'u përballur me tabunë, dhimbjen, kufirin mes jetës dhe vdekjes apo fundin e përvojës tokësore. Si rrjedhojë e kujtesës së ripërtëritë për të vdekurit, njerëzit kanë menduar dhe besuar përherë në forma të jetës së përtëjshme, për të shpresuar në një vazhdim të asaj që vdekja ka ndërprerë. Studiuesit theksojnë se kjo përpjekje për të gjetur një formë ekzistence përtej jetës gjeneroi sisteme që mbështeteshin në ide, besime e madje përfytyrime të detajuara të rrugëve nëntokësore në botën e përtëjme, pra në jetën pas vdekjes.

Ky koncept i përfytyrimeve të dikurshme për të lidhur botët sot realizohet falë formave të inteligjencës artificiale që ofrojnë një mundësi takimi mes nesh dhe të vdekurve duke i "ngjallur" ata. Sigurisht ringjallja është metaforë për rindërtimin digjital të pranisë së njerëzve të dashur përmes teknologjive që përpunojnë të dhëna specifike. Në këtë kuptim, këto forma simulimi shtynë në skaje atë që ligjërimi bën qysh se është dokumentuar: përpiket të mbajë mes nesh të vdekurit, duke mundur idenë e vdekjes si gjendje e pashkapërcyeshme.

Ndryshe prej zgjedhjes radikale për "ringjalljen" e të vdekurit, që simulon një përzierje të pranisë dhe të mungesës, eufemizmat janë një zgjedhje e vjetër, e njohur, e studiuar për të zbutur dhunën, befasinë me të cilën vdekja na përball. Për më tepër, falë rrugëtimit të tyre në sinkroni e diakroni, eufemizmat rindërtojnë historinë shoqërore të ligjëritimit mbi një temë. Do të ishte e volitshme të hulumtoheshin ndryshimet që ka pësuar paraqitja socio-kulturore dhe gjuhësore e vdekjes. Pavarësisht se nuk ishte ndër qëllimet e punimit, disa aspekte të këtyre ndryshimeve i kemi cekur kalimthi duke paraqitur në korpus eufemizma me vlerë të theksuar kontekstuale dhe me fuqi risemantizuese, si në rastin e shembujve "*dorëzoi triskën*", "*dorëzoi tollonin*" (vdiq). Në kulturën tonë, një ndjenjë frike dhe respekti njëkohësisht i ka shtyrë njerëzit t'u kushtojnë të vdekurve vëmendje dhe nderim të veçantë.

Krahasimisht me ritualet që lidhen me lindjen dhe martesën, të cilat janë trajtuar gjerësisht në studimet etnologjike, antropologjike dhe gjuhësore, dukuria e vdekjes dhe mënyrat e shprehjes së saj në gjuhë kanë mbetur më pak të hulumtuara, ndonëse bëjnë pjesë ndër përvojat më themelore të jetës njerëzore. Eufemizmat për vdekjen, në pjesën më të madhe, ndonëse janë përmendur si lëndë, nuk janë shoqëruar me analiza të thelluara ose me shpjegime të plota. Ndjesia është se gjatë periudhës së komunizmit

kjo mungesë trajtimesh mund të lidhet me një qëndrim të rezervuar ndaj studimeve që kishin si objekt vdekjen, temë që nuk përputhej me diskursin ideologjik të kohës. Në kushtet e diktaturës, vdekja nuk përbënte një temë të përshtatshme për diskursin publik, pasi ajo binte në kundërshtim me imazhin propagandistik të jetës së bukur, të shoqërisë pa konflikte dhe të “njeriut të ri” të shëndetshëm e ideologjikisht të formuar, që paraqitej si model në shoqërinë socialiste.

Në rrafsh përmbajtjesor eufemizmat e marrë në shqyrtim sugjerojnë temën e kujtesës, identitetit, përfshirjes, por edhe përjashtimit të dukurisë së vdekjes. Kompleksiteti i shtresëzimeve, risemantizimi dhe ndërtime të reja ende të pavjela, por të gjalla në ligjërim legjitimojnë një vazhdimësi të pashmangshme në këtë lëmë.

Duke vërejtur larminë e përbërësve të këtyre eufemizmeve dhe strukturën e tyre në gjuhën shqipe, eufemizmat që lidhen me vdekjen dallohen edhe për shumëllojshmëri gramatikore, leksikore dhe stilistike. Kjo shumësi formash dhe modelesh pasqyron fleksibilitetin e sistemit gjuhësor dhe mënyrat e ndryshme me të cilat folësit shmangin emërtimin e drejtpërdrejtë të vdekjes, duke e zbutur atë përmes mjeteve të ndryshme shprehëse.

BIBLIOGRAFI

- A. ÇEPANI – R. MARTETA, *Arti i eufemizmeve të shqipes: një vështrim për anën semantike-leksikore dhe formimin e tyre*, in *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2026, 75-108.
- A. DOJA, *Shfaqja e antropologjisë në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Kristalina-KH, Tiranë 2018.
- A. KOSTALLARI et al., *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë 1980.
- A. LAMA, *Pasuri të ligjërimit shqip II*, Akademia e Studimeve Albanologjike 2021.
- A. NIKOLLA, *Njeriu i ri shqiptar: ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit*, Onufri, Tiranë 2012.
- E. BENVENISTE, *Problemi di linguistica generale*, Il Saggiatore, Milano 2010.
- E. ÇABEJ, *Disa eufemizma të shqipes*, B.I.SH., Tiranë 1949, 72-84.
- E. ÇABEJ, *Disa eufemizma të shqipes*, in *Studime gjuhësore*, IV, Prishtinë 1978.
- F. AGALLIU et al., *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I Morfologjia*. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2002.

- Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe*, 24.03.2026, <https://fjalori.online/>
- G. LAKOFF – M. JOHNSON, *Metaphors we live by*, University of Chicago Press, Chicago 1980.
- GJ. SHKURTAJ, *Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Eqrem Çabejt*, in *Eqrem Çabej personalitet i shquar i shkencës dhe kulturës shqiptare*, Studime shqiptare 9.
- GJ. SHKURTAJ, *Etnografia e të folurit*, Tiranë 2004.
- H. SHEHU, *Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe, II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2024.
- I Lumi ALEKSANDËR SIRDANI, *Fjalë ari*, Botime Françeskane, Shkodër 2024.
- K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Euphemism and Dysphemism: Language Used as Shield and Weapon*, Oxford University Press, New York 1991.
- K. ALLAN – K. BURRIDGE, *Forbidden Words: Taboo and the Censoring of Language*, Cambridge University Press, Cambridge 2006.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 24.03.2026, <https://kanuni.org/>
- M. BLANCHOT, *Lo spazio letterario*, Il Saggiatore, 2018.
- M. IBRAHIMI, *Eufemizmat e shqipes në rrafshin krahasues me kulturat ballkanike sipas Eqrem Çabejt*, in *Eqrem Çabej – figurë që shkëlqeu*, 84-93.
- M. IBRAHIMI, *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*, Shkup 2009.
- M. TIRTA, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2004.
- M.-H. RUTSCHOWSCAYA, *Morte e sopravvivenza in Egitto*, in *Grande dizionario delle religioni M-Z*, Cittadella editrice – Edizioni Piemme, Casale Monferrato – Assisi 1988, 1432.
- PH. ARIÈS, *Storia della morte in Occidente*, Rizzoli 1978.
- R. MARTETA, *Letra grues seme të vdekun*, “Shêjzat” III (2018), 1-2, 131-134.
- S. FREUD, *Psicoanalisi della società moderna. Il nostro atteggiamento nei confronti della morte*, Newton, Roma 2010.
- SH. ISLAMAJ, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 1985.
- T. OSMANI – S. PEPA, *Pasqyrimi i eufemizmave në letërsinë gojore dhe artistike*, “Buletini i Shkencave Shoqërore” 28 (1995-1996), 1, 35-49.
- T. OSMANI – S. PEPA, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër 2000.
- T. OSMANI – S. PEPA, *Vëzhgime për disa eufemizma të shqipes*, “Gjuha jonë” XII (1992), 1-2, 25-31.
- T. PLANGARICA, *Shkencat e ligjërit dhe diskursi letrar*, AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË, INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË 2026.
- T. TODOROV, *Struttura profonda dell'enunciazione*, in *Teorie del simbolo*,

- Garzanti, Milano 2008.
- T. VAN DIJK, *Discourse and ideology*, in T. A. VAN DIJK (ed.), *Discourse and ideology*, London, SAGE Publications, 2011, 379-407.
- V. MEMISHA, *Nëpër hapësirat semantike të fjalës shqipe*, Tiranë 2010.
- V. MESSORI, *Scommessa sulla morte. La proposta cristiana: illusione o speranza*, Edizioni SEI, Torino 2001.
- V. NIZZO, *Riflessioni conclusive a margine del convegno sull'archeologia della morte in Illiria ed Epiro*, in G. LEPORE – B. MUKA (ed.), *Archeologia della morte in Illiria ed Epiro. Contesti, ritualità e immagini tra età ellenistica e romana*, Quasar, Roma 2020.
- XH. LLOSHI, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, shblu 2001.